



Datë: 09.06.2025
Numër Protokolli: 3894/2025

A.nr.728/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj – Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 728/2025, të datës 25.04.2025, të parashtruar nga ankuesi B.K, kundër organit të punësimit Ministra e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*transferim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr. 728/2025, e datës 25.04.2025, e parashtruar nga ankuesi B.K

II. Mbetet në fuqi, Vendimi me numër 1143, i datës 26.03.2025, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil B.K, (në tekstin e mëtejme referuar: ankues) me datë 25.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 1143, të datës 26.03.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me transferimin e përkohshëm nga pozita Udhëheqës i Divizionit për Administrimin të Dokumenteve dhe Arkiv, në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Kulturë Rini dhe Sport, në Departamentin për Diasporë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 30.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit, më datë 06.05.2025 ka përcjellë shkresat e lëndës lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.Nr.2740/2025 të datës 25.04.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për B.K; Vendimi me numër 1143, i datës 26.03.2025, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Emali i datës 26.03.2025, dërguar nga

A.M, për B.K; Vendimi me numër protokolli 762, i datës 26.02.2025; emali i datës 06.12.2024; Emaili i datës 24.02.2023, dërguar nga A.M, për B.I; Kërkesë me numër protokolli 863, e datës 24.02.2023; lidhur me kthimin e zyrtares së arkivit; emali i datës 23.08.2022; emali i datës 01.12.2022; emali i datës 05.12.2022; emali i datës 06.12.2022; Vendimi me numër protokolli 1908, i datës 01.06.2022, i nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Akt Emërimi me numër protokolli 2093, i datës 13.06.2022; emali i datës 07.05.2024, dërguar nga B.K, për R.Z; emali i datës 30.11.2022; emali i datës 15.04.2024; emali i datës 18.04.2024, dërguar nga B.K, për H.B; emali i datës 26.03.2025, dërguar nga B.K, për R.Z; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.04.2025, dërguar nga R.K, për H.B; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 728/2025, e datës 06.05.2025; emali i datës 24.02.2023, dërguar nga A.M, për B.I etj; Vendimi me numër protokolli 1908, i datës 01.06.2022, i nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Akt Emërimi me numër protokolli 2093, i datës 13.06.2022, për G.S; Emali i datës 07.05.2024, dërguar nga B.K ,për R.Z; emali i datës 30.11.2023, dërguar nga B.K; emali i datës 15.04.2024, dërguar nga B.K; për H.B; emali i datës 18.01.2024, dërguar nga B.K; për H.B; emali i datës 26.03.2024, dërguar nga B.K; për R.Z; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Akt Emërimi me numër protokolli 5947, i datës 07.11.2024, për B.K; Akt Emërimi i datës 05.09.2012, për B.K; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 15.03.2019; Certifikatë e muajit shkurt të vitit 2003; Certifikatë e datës 16.05.2000; Certifikatë e vitit 2002, për B.K; certifikatë e datës 19.09.2008 ;Diplomën për B.K, e lëshuar nga Akademia Diplomatike Shqiptare; Diplomë me numër protokolli 3572, e datës 05.02.2019, për B.K, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës ‘‘Hasan Prishtina’’; Certifikatë e datës 29.12.2000, për B.K.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli Nr. 5947 të datës 07.11.2024, është i punësuar në pozitën ‘‘Udhëheqës i Divizionit për Administrimin të Dokumenteve dhe Arkiv ’, në Divizionin për Administrimin të Dokumenteve dhe Arkivit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Tutje Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes Vendimit me numër 1143, i datës 26.03.2025, ankuesin e ka transferuar me mënyrë të përkohshme nga pozita Udhëheqës i Divizionit për Administrimin të Dokumenteve dhe Arkiv, në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Kulturë Rini dhe Sport, në Departamentin për Diasporë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me arsyetimin për arsye të interesit të institucionit.

Ankuesi B.K, i pakënaqur me vendimin me numër 1143, të datës 26.03.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 25.04.2025 parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore kundër vendimit lidhur me transferimin e përkohshëm të nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesi në ankesën e tij pretendon edhe për vështërsit në përmbushjen e detyrave të tij sepse sipas ankuesit ka pasur ndërhyrje gjatë kryerjes së punës, Kolegji konstaton se këto pretendime të ankuesit nuk janë relevante lidhur me marrjen ndryshe të vendimit nga ana e Kolegjit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me transferimit të ankuesit sipas Vendimit me numër 1143, i datës 26.03.2025, të nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ju referuar dispozitave ligjore në fuqi, gjegjeshit nenit 63, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ku thuhet se; *1.Nëpunësja/i civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori në këto raste:1.1. kur është në interes të institucionit, prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) vjetëve, po ashtu*

Kolegji ju referuar edhe dispozitave të nenit 4, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1, nenin 5, paragrafi 1,2,3,4,5,6,të Rregullores (QRK) nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se;1. *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) viteve;1. Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit, me kërkesë të institucionit.2. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit mund të propozohet nga Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i nëpunësit apo drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit.3. Vendimi për transferim është vendim i arsyetuar i drejtuesit më të lartë administrativ të institucionit.4. Arsyetimi i vendimit të transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, përmban vlerësimin së nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet. Ky vlerësim kryhet nga NjMBNj e institucionit ku nëpunësi është i punësuar. 5. NjMBNj e institucionit ku nëpunësi është i punësuar e njofton me shkrim nëpunësin që do të transferohet lidhur me vendimin e transferimit.6. Transferimi sipas këtij nenit, mund të bëhet në periudhë prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) viteve.*

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon se nuk i plotëson kushtet për tu transferuar përkohshëm në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Kulturë Rini dhe Sport”, në Departamentin për Diasporë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për shkak se ankuesi nuk posedon përgatitje profesionale, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka analizuar edhe përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Kulturë Rini dhe Sport”, dhe nga përshkrimi i detyrave të punës del se kriteret janë si në vijim *Diplomë universitare në Art, Shkenca Politike Juridik, Ekonomik Shkenca tjera shoqërorë, natyrorë ose teknike me të paktën 240, kredi /ETCS, apo ekuivalentë me to*, dhe nisur nga ky konstatim Kolegji i Këshillit konstaton së nga shkresat e lëndës konstatohet se ankuesi sipas Diplomës me numër protokolli 3572, të datës 05.02.2019, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, ka përfunduar studimet Ekonomist i Diplomuar, me çka nënkuptohet se ankuesi i ka plotësuar kushtet për tu transferuar në pozitën ‘Udhëheqës i Divizionit për Kulturë Rini dhe Sport”, në pajtim me përgatitjen profesionale të tij, dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimore i ankuesit është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, rastin e nxjerrjes së vendimit me numër 1143, të datës 26.03.2025, të, me datë 25.04.2025, përmes të cilit vendim ankuesin e ka transferuar përkohësisht në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Kulturë Rini dhe Sport”, në Departamentin për Diasporë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren (QRK) nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me rastin e ankuesit B.K

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr 728/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.K;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së